



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL (AAC)

DHE

AUTORITETIT SHETËROR PËR INFORMACIONIN

GJEOPAPËSINOR (ASIG)

PËR

**KOORDINIMIN E NDËRVEPRIMIT MIDIS ASIG DHE AAC-SË, MBI
PAJISJEN NË KOHË TË AAC-SË, ME TË DHËNA TË PËRDITËSUARA MBI
TERRENIN NË PËRMBUSHJE TË KËRKESAVE LIGJORE MBI VLERËSIMIN
E PENGESAVE TË AVIACIONIT CIVIL NË ZONAT E MBROJTURA
AEROPORTUALE.**

Tiranë, 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

AUTORITETI SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN
GJEOHAPËSINOR

Nr. 2833 Prot, datë 14 / 11 / 2025

Nr. 534 Prot, datë 17 / 11 / 2025

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL (AAC)

DHE

AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

(ASIG)

PËR

KOORDINIMIN E NDËRVEPRIMIT MIDIS ASIG DHE AAC-SË, MBI
PAJISJEN NË KOHË TË AAC-SË, ME TË DHËNA TË PËRDITËSUARA MBI
TERRENIN NË PËRMBUSHJE TË KËRKESAVE LIGJORE MBI VLERËSIMIN
E PENGESAVE TË AVIACIONIT CIVIL NË ZONAT E MBROJTURA
AEROPORTUALE.

HYRJE

Autoriteti i Aviacionit Civil (në vijim referuar si “AAC”), përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Maksim Et'hemaj

dhe

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (në vijim referuar si “ASIG”), përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Znj. Vilma Tomço,

Për të konsoliduar bashkëpunimin dhe koordinimin institucional në drejtime konkrete palët bien dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi.

Duke konsideruar se Shqipëria është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) që nga viti 1990, me Dekretin e Presidentit nr. 7438, datë 1.12.1990;

Duke konsideruar se Shqipëria, nëpërmjet auditeve të ICAO USOAP, është subjekt i vlerësimit të nivelit të implementimit efektiv të standarteve dhe praktikave të rekomanduara të ICAO-s në sistemin e mbikëqyrjes në operim të saj;

Duke pranuar se një nivel i lartë i implementimit efektiv është një tregues kyç i sistemit shtetëror të mbikëqyrjes së sigurisë në operim;

Duke njohur rolin e rëndësishëm që kanë të gjithë entitetet rregullatore dhe industria, duke përfshirë AAC dhe ASIG, në maturitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit të sigurisë në operim në Shqipëri dhe shkëmbimit sa më efikas të informacionit ndër institucional, dhe

Duke konsideruar se ASIG, është përgjegjës për ngritjen dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor (NSDI) në Shqipëri, duke ofruar nëpërmjet shërbimeve të rrjetit të dhënave dhe shërbimet gjeohapësinore, të vëna në dispozicion nga autoritetet publike përgjegjëse, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Duke konsideruar se AAC, është përdorues i këtyre të dhënave për shkak të ushtrimit të funksioneve të tij të përcaktuara në ligjin nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së SHqipërisë”, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij,

ASIG dhe AAC angazhohen plotësisht për zbatimin e veprimeve të parashikuara në këtë Memorandum, si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi është koordinimi i ndërveprimit midis ASIG dhe AAC, mbi pajisjen në kohë të AAC-së, me të dhëna të përditësuara mbi terrenin në përmbushje të

kërkesave ligjore mbi vlerësimin e pengesave të aviacionit civil në zonat e mbrojtura aeroportuale.

Neni 2

Autoritet dhe përgjegjësitë

1. ASIG është institucioni publik qendror përgjegjës për zbatimin e politikës kombëtare për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor, i cili ushtron funksionet e tij në përputhje me ligjin me nr. 72/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. AAC është enti publik i rregulluar me ligjin nr 53/2022 *“Për funksionimin dhe organizimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”*, i cili kryen funksionet e Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës për të gjithë aktivitetet e Aviacionit Civil në Republikën e Shqipërisë, sipas funksioneve të përcaktuara në ligjin Nr. 96/2020 *“Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”*, me qëllim garantimin e sigurisë në operim dhe sigurisë së aviacionit civil.

Neni 3

Koordinimi për sigurimin e të dhënave të terrenit

1. AAC do t'i komunikojë zyrtarisht ASIG, çdo nevojë që do të ketë për të dhënat statike mbi një terren të caktuar, i cili shtrihet brenda nje rrezeje 45 km nga pika e referimit të aeroportit.
2. Çdo kërkesë e AAC për të dhënat e terreneve statike do të përshkruajë qartë, zonën e interesit dhe kërkesat mbi cilësinë e të dhënave aeronautike sipas Urdhrit të Ministrit nr. 296, datë 29.7.2021, *“Për Miratimin e Rregullores “Mbi Shërbimin e Informacionit Aeronautik në Republikën e Shqipërisë”*.
3. Në rastet kur AAC-së, për vlerësime aeronautike, mund t'i nevojiten të dhënat dinamike të terrenit, AAC, në kërkesën për ASIG do të përcaktojë qartë koordinatat lidhur me strukturën apo objektin përkatës.
4. Në çdo rast, ASIG do të mundësojë për AAC-në ato të dhëna të terrenit të cilat i ka të disponueshme.
5. ASIG do të sigurohet të vendosë në dispozicion të dhënat e terrenit në kohën më të shpejte të mundshme, sipas formatit WGS-84.
6. Mënyra e shpërndarjes së të dhënave do të mundësohet sipas përcaktimeve të VKM-së Nr. 399, datë 19.06.2019, *“Rregullat për Shkëmbimin e Grupeve dhe të Shërbimeve të të Dhënave Gjeohapësinore mes Autoriteteve Publike”*.
7. ASIG dhe AAC do të koordinojnë në rastet e përditësimit së të dhënave të terrenit, duke u siguruar që ato të reflektojnë situatën reale në kohën e kërkuar.
8. AAC dhe ASIG do të bashkëpunojnë për të kryer studime apo fotografime në interes të aviacionit civil.
9. AAC bazuar në VKM-në nr. 942, datë 19.11.2015, *“Për miratimin e rregullores ‘Për Planifikimin dhe Realizimin e Fotografimit Ajror të Territorit të Republikës së Shqipërisë’”*, angazhohet të trajtojë me përparësi dhe brenda një afati sa më të shpejtë kërkesat për leje të paraqitura nga ASIG, për projekte në fushën e gjeoinformacionit.

10. AAC në përputhje me parashikimet e Urdhrit nr. 143, datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilot”, garanton shqyrtimin dhe trajtimin me prioritet të aplikimeve të ASIG për lejet e operimit të avionëve pa pilot (UAS), në përputhje me konceptin e përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore mbështetur në VKM nr. 593, datë 18.10.2023, në përputhje me standartet e sigurisë ajrore dhe ligjore.
11. AAC dhe ASIG bien dakord të zhvillojnë takime periodike për koordinimin e operimeve ajrore dhe për shqyrtimin e procedurave, me qëllim rritjen e efikasitetit, përputhshmërisë me standartet e sigurisë dhe integritetin e të dhënave gjeohapësinore.

Neni 4

Konfidencialiteti dhe shpërndarja e informacionit

Bazuar në kërkesën e secilës palë, ASIG dhe AAC do të shkëmbejnë informacion dhe dokumente në lidhje me aktivitetet që do të kryhen në zbatim të këtij Memorandumi. Ky informacion do të përdoret në përputhje me legjislacionin në fuqi për trajtimin e dokumentave zyrtare.

Neni 5

Njoftimi dhe komunikimi

1. Për zbatimin e këtij memorandumi, ASIG dhe AAC do të komunikojnë në formë shkresore, ose me e-mail nëpërmjet pikave të kontaktit të mëposhtëme:
 - a. Për zbatimin e këtij memorandumi pikë kontakti për ASIG është Z. Dritan Prifti, Drejtor i Drejtorisë së Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing, me adresë e_mail-i Dritan.Prifti@asig.gov.al.
 - b. Për zbatimin e këtij memorandumi pikë kontakti për AAC është Znj. Selma Pagria, me adrese e_mail-i selma.pagria@acaa.gov.al.
2. Çdo ndryshim i pikës së kontaktit, i komunikohet menjëherë palës tjetër, nëpërmjet shkresës ose E-mailit zyrtar.

Neni 6

Parashikimet Përfundimtare

1. Ky memorandum është hartuar në gjuhën shqipe, në dy (2) kopje.
2. Asnjë amendim, shtesë ose ndryshim tjetër i këtij Memorandumi nuk do të jetë efektiv, përveç në rast se ai është në formë të shkruar, i referohet këtij memorandumi dhe është nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës Palë të këtij memorandumi.

Tiranë, më 14 / 11 /2025

**PËR AUTORITETIN E AVIACIONIT
CIVIL**

**MAKSIM ET'HEMAJ
DREJTOR EKZEKUTIV**



**PËR AUTORITETIN SHTETËROR
PËR INFORMACIONIN
GJEOHAPËSINOR**

**VILMA TOMÇO
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

